



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/191

Datë: 18.06.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15. paragrafi 4. të Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare për vitin 2015.
2. Agjencia e Statistikave e Kosovës është e obliguar që pjesën e implikimeve financiare të këtij plani ta harmonizoj me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës të vitit 2015.
3. Obligohet Agjencia e Statistikave e Kosovës, për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij vendimi në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë